
VENDIMI ZBATUES I KOMISIONIT (BE) 2016/1251, DATË 12 KORRIK 2016, "PËR MIRATIMIN E NJË PROGRAMI SHUMËVJEÇAR TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR MBLEDHJEN, MENAXHIMIN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË SEKTORËT E PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS PËR PERIUdhËN 2017-2019" (NJOFTUAR ME DOKUMENTIN NUMËR C(2016) 4329)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 199/2008, datë 25 shkurt 2008, për ngritjen e një kuadri komunitar për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen e këshillimit shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit¹, dhe në veçanti nenin 3 të saj,

Meqë:

1. Sipas nenit 3 të Rregullores (KE) nr. 199/2008, një program shumëvjeçar i Bashkimit Evropian për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit duhet të miratohet për një periudhë tre vjeçare me qëllim që të garantojë zbatimin e njëtrajtshëm të detyrimit për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave.

2. Programi aktual shumëvjeçar bazohet në programin shumëvjeçar për periudhën 2011-2013, i cili u zgjat me Vendimin Zbatues të Komisionit C(2013)5243 për të mbuluar periudhën nga miratimi i Rregullores (BE) nr. 1380/2013 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit² deri më 31 dhjetor, 2016. Ndaj duhet të zhvillohet një program shumëvjeçar i Bashkimit Evropian për një periudhë tre vjeçare, duke nisur nga data 1 janar 2017.

3. Sipas nenit 25 të Rregullores (BE) nr. 1380/2013, shtetet anëtare mbledhin të dhënat biologjike, mjedisore, teknike dhe social ekonomike që nevojiten për menaxhimin e sektorit të peshkimit. Shtetet anëtare kanë nevojë për programin shumëvjeçar të Bashkimit Evropian në mënyrë që të specifikojnë dhe planifikojnë veprimtaritë për mbledhjen e të dhënave në planet kombëtare të punës. Në përputhje me nenin 21 të Rregullores (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit³ këto plane kombëtare të punës duhet t'i dorëzohen Komisionit deri më datën 31 tetor, që paraprin vitin për të cilin zbatohet plani i punës.

4. Programi shumëvjeçar i Bashkimit Evropian duhet të përcaktojë kërkesat për mbledhjen e të dhënave, në përputhje me nenin 1 të Rregullores (KE) nr. 199/2008. Ai duhet të përmbajë elementet që nevojiten për zbatimin e politikës së përbashkët për peshkimin për sa kohë që këto elemente nuk kërkohen edhe sipas kuadrove të tjera legjislative.

5. Me qëllim për të arritur objektivat e politikës së përbashkët të reformuar për peshkimin, që përcaktohet në nenin 2 të Rregullores (BE) nr. 1380/2013, duhet që të

përditësohen kërkesat në BE për të dhënat për të pasur këshilla shkencore të sakta për periudhën që nis më datë 1 janar 2017.

6. Gjithashtu, detyrimet dhe angazhimet e reja ndërkombëtare që i janë vendosur shteteve anëtare dhe BE-së nga marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe për peshkimin kërkojnë përfshirjen e disa kërkesave në lidhje me mbledhjen e të dhënave në programin shumëvjeçar të BE-s, në veçanti ato që lindin nga Marrëveshjet e Partneritetit për Peshkim të Qëndrueshëm (SFPA).

7. Vlerësimi i kuadrit aktual për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe konsultimet pasuese me grupet e interesit kanë treguar se programi shumëvjeçar i BE-së, në vend që të përqendrohet në metodat për mbledhjen e të dhënave, duhet të përqendrohet në të dhënat që kërkojnë nga shtetet anëtare Kërkesat metodologjike përshkruhen në planet e punës së shteteve anëtare që duhet të miratohen nga Komisioni pas bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet shteteve anëtare në nivel të rajoneve detare.

8. Ndaj, programi i BE-së për periudhën 2017-2019 duhet të marrë në konsideratë të gjithë këta elemente dhe objektivat e Rregullores (BE) nr. 1380/2013, në veçanti nenet 2 dhe 25 të saj, deri në masën e mundshme brenda kuadrit ligjor aktual që parashikohet në Rregulloren (KE) nr. 199/2008. Kur kërkesat e reja për të dhëna shkojnë përtej kuadrit ligjor aktual, ato duhet të jenë opsionale. Sapo të hyjë në fuqi një kuadër i ri ligjor që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 199/2008, Komisioni mund të ndryshojë programin shumëvjeçar të BE-së, nëse është e nevojshme, në mënyrë që ai të pasqyrojë çdo kërkesë të re për mbledhjen e të dhënave.

9. Komisioni ka marrë në konsideratë rekomandimet që kanë dalë nga konsultimi në Takimet për Koordinim Rajonal, të përmendura në nenin 5 të Rregullores (KE) nr. 199/2008 dhe Komitetit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin (STECF). Janë kryer konsultime edhe me organe të tjera shkencore konsultuese siç është Këshilli Ndërkombëtar për Kërkime në Det (ICES), dhe, përfaqësuesit e shteteve anëtare janë mbledhur në grupe të posaçme ekspertësh.

10. Për arsye të sigurisë ligjore, Vendimi Zbatues nr. C(2013)5243 duhet të shfuqizohet.

11. Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Menaxhimit për Peshkimin dhe Akuakulturën,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Programi shumëvjeçar i BE-së për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit për periudhën 2017-2019, siç përmendet në nenin 3 të Rregullores (KE) nr. 199/2008, është paraqitur në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Shfuqizimi i Vendimit Zbatues nr. C(2013)5243 hyn në fuqi më datë 1 janar 2017.

Neni 3

Ky vendim u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 12 korrik 2016.

Për Komisionin

Karmenu VELLA

Anëtar i Komisionit

SHTOJCA

KREU I

PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj shtojce, zbatohen përkufizimet në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1224/2009⁴, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 404/2011⁵, dhe Rregulloren (BE) nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁶. Gjithashtu, zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

1. Anije aktive peshkimi: anijet e peshkimit që kanë kryer veprimtari peshkimi (një ose disa ditë) gjatë një viti kalendarik. Një anije peshkimi që nuk ka kryer veprimtari peshkimi gjatë një viti kalendarik konsiderohet si "joaktive".

2. Specie anadrome: burime ujore të gjalla me cikël jetësor që nis nga lindja e larvave/të vegjëlve në ujëra të ëmbla, migrimin në ujëra të kripura, kthimin dhe në fund lëshimin e vezëve në ujëra të ëmbla.

3. Specie katadrome: burime ujore të gjalla me cikël jetësor që nis nga lindja e larvave/të vegjëlve në ujëra të kripura, migrimin në ujëra të ëmbla, kthimin dhe në fund lëshimin e vezëve në ujëra të kripura.

4. Fraksion i zënies: një pjesë e zënies totale, si pjesa e zënies mbi përmasën referencë minimale të ruajtjes, pjesa e zënies nën përmasën referencë minimale të ruajtjes, pjesa e hedhurinave nën përmasën referencë minimale të ruajtjes, hedhurinat de minimis ose hedhurinat.

5. Ditë në det: çdo periudhë e vazhdueshme prej 24 orësh (ose pjesë e saj) gjatë së cilës një mjet lundrues qëndron në një zonë ose nuk paraqitet në port.

6. Ditë peshkimi: çdo ditë kalendarike në det në të cilën kryhen veprimtari peshkimi, pa cenuar detyrimet ndërkombëtare të BE-së dhe shteteve anëtare të tij. Një dalje për peshkim mund të kontribuojë në shumën e ditëve të peshkimit për pajisjet pasive të peshkimit dhe në shumën e ditëve të peshkimit për pajisjet aktive të peshkimit gjatë asaj daljeje për peshkim.

7. Zonë peshkimi: (grupi i) njësitë gjeografike ku kryhen veprimtari peshkimi. Këto njësi miratohen në nivel rajoni detar bazuar në zonat ekzistuese të përcaktuara nga organizatat rajonale për menaxhimin e peshkimit ose organet shkencore.

8. Segment i flotës: grupi i mjeteve lundruese që i përkasin të njëjtës kategori gjatësie (LOA, gjatësia e përgjithshme) dhe mbajnë të njëjtat pajisje peshkimi gjatë vitit.

9. Profesione: një grup veprimtarish peshkimi që kanë për qëllim zënien e specieve të ngjashme, duke përdorur mjete të ngjashme⁷, në të njëjtën periudhë të vitit dhe/ose në të njëjtën zonë, si edhe të karakterizuara nga modele të ngjashme shfrytëzimi.

10. Studime shkencore në det: ekspedita të kryera me një mjet lundrimi studimor, ose një mjet lundrimi të posaçëm për kërkime shkencore për monitorimin e rezervave dhe ekosistemit dhe të përcaktuara për këtë detyrë nga organi përgjegjës për zbatimin e planit kombëtar të punës, i ngritur në përputhje me nenin 21 të Rregullores (BE) nr. 508/2014.

KREU II

METODAT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Metodat për mbledhjen e të dhënave dhe cilësia e tyre përshtaten me qëllimet e synuara, të përcaktuara në nenin 25 të Rregullores (BE) nr. 1380/2013 dhe ndjekin praktikën më të mira dhe metodologjitë përkatëse të këshilluara nga organet shkencore përkatëse. Për këtë qëllim, metodat dhe rezultati i zbatimit të metodave shqyrtohen rregullisht nga organet shkencore të pavarura me qëllim që të verifikohet përshtatshmëria e tyre për sa i përket menaxhimit të politikës së përbashkët për peshkimin.

KREU III

KËRKESAT PËR TË DHËNA

1. Grupe të dhënash

1.1. Si pjesë e planeve të punës të hartuara në përputhje me nenin 21 të Rregullores (BE) nr. 508/2014, shtetet anëtare përcaktojnë të dhënat që duhet të mblidhen ndër grupet e mëposhtme, siç specifikohen në pikat 2 deri në 7 të këtij kreu:

a) të dhëna biologjike, sipas fraksionit të sasisë së kapur, për rezervat e peshkut të zëna nga veprimtaritë e peshkimit tregtar nga BE-ja, në ujërat e BE-së dhe jashtë tij, dhe nga veprimtaritë e peshkimit argëtues në ujërat e BE-së;

b) të dhëna për të vlerësuar ndikimin e peshkimit nga BE-ja në ekosistemet detare në ujërat e BE-së dhe në ujërat jashtë tij.

c) të dhëna të detajuara për veprimtarinë e anijeve të peshkimit nga BE në ujërat e BE-së dhe jashtë tij, siç raportohen sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009;

d) të dhëna sociale dhe ekonomike për peshkimin⁸;

e) të dhëna sociale, ekonomike dhe mjedisore për akuakulturën;

1.2. Të dhënat që duhet të grumbullohen përputhje me nenet 3, 4 dhe 5 të Rregullores (KE) nr. 199/2008 dhe duke marrë në konsideratë caqet e përcaktuara në kreun V të kësaj shtojce.

1.3. Të dhënat grumbullohen për të mundësuar nxjerrjen e vlerësimeve të vlefshme për llojin e peshkimit, periodat e përkohshme dhe zonat bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë, të miratuara në nivel të rajonit detar. Shpeshhtësia për mbledhjen e të dhënave koordinohet në nivel rajoni detar, përveç se kur deklarohet ndryshe në këtë shtojcë dhe në tabelat përkatëse.

2. Të dhëna biologjike për rezervat e kapura gjatë veprimtarive të peshkimit tregtar nga BE-ja, në ujërat e BE-së dhe jashtë tij, dhe nga veprimtaritë e peshkimit argëtues në ujërat e BE-së;

Këto të dhëna përbëhen nga elementet e mëposhtme:

a) Sasitë e kapura sipas specieve dhe të dhënat biologjike nga mostrat individuale që mundësojnë vlerësimin e:

I. Për veprimtaritë e peshkimit tregtar, volumin dhe frekuencën e gjatësisë së të gjitha fraksioneve të peshkut të kapur (duke përfshirë sasitë që hidhen sërish në det dhe sasitë e padëshiruara) për rezervat e paraqitura në tabelat 1A, 1B dhe 1C, e raportuar si niveli i agregimit 6, siç përcaktohet në tabelën 2. Zgjidhja kohore koordinohet në nivel rajoni detar bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë;

II. Për veprimtaritë e peshkimit tregtar, pesha mesatare dhe mosha e sasisë së kapur të rezervave të paraqitura në tabelën 1A, 1B dhe 1C. Përzgjedhja e rezervave nga të cilat duhet të grumbullohen këto variabla dhe zgjidhja kohore koordinohet në nivel rajoni detar bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë;

III. Për veprimtaritë e peshkimit tregtar, të dhëna për raportin mes gjinive, pjekurinë dhe pjellorinë për rezervat e paraqitura në tabelat 1A, 1B dhe 1C të sasive të kapura, sipas shpeshhtësisë që nevojitet për këshilla shkencore. Përzgjedhja e rezervave nga të cilat duhet të grumbullohen këto variabla dhe zgjidhja kohore koordinohet në nivel rajoni detar bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë;

IV. Për veprimtaritë e peshkimit çlodhës/argëtues (numri dhe pesha ose gjatësia) e sasisë së kapur dhe lëshimet për speciet e paraqitura në tabelën 3 dhe/ose speciet e identifikuara në nivel rajoni detar, siç nevojitet për qëllimet e menaxhimit të peshkimit; të dhënat për nevojat e përdoruesve fundorë sipas moshës ose të dhënat e tjera biologjike, siç specifikohen në paragrafët I-III, për veprimtaritë e peshkimit çlodhës/argëtues vlerësohen në nivel rajoni detar.

b) Përveç të dhënave të grumbulluara sipas germës "a", të dhënat për speciet anadrome dhe katadrome të paraqitura në tabelën 1E, të kapura gjatë veprimtarive të peshkimit tregtar gjatë ciklit të tyre jetësor në ujëra të ëmbla, pavarësisht mënyrës se si kryhen këto veprimtari peshkimi, si në vijim:

I. variabellet që lidhen me rezervat (për mostra individuale, për moshën, gjatësinë, peshën, gjininë, pjekurinë dhe pjellorinë, sipas fazës jetësore, por specifikuar më tej mbi bazën e species dhe rajonit); dhe

II. sasitë vjetore të kapura sipas kategorisë së moshës ose fazës së jetës.

c) Gjithashtu:

Për sa i përket ngjalës, informacione (p.sh., të dhëna, parashikime, tendenca relative, etj.) të grumbulluara çdo vit të paktën në një basen lumor për njësinë e menaxhimit të ngjalës për:

I. bollëkun e rekrutëve;

II. bollëkun e rezervave të përhershme (ngjala e verdhë); dhe

III. numrin ose peshën dhe raportin mes gjinisë së ngjalës së argjendtë migruese;

Dhe për sa i përket të gjithë salmonit të egër: informacioni grumbullohet çdo vit - përveç se kur bihet dakord ndryshe në nivel rajona - për bollëkun e salmonit të ri dhe salmonit të rritur dhe numrin e individëve që ngjiten në ujërat e ëmbla.

Emërtimi i lumenjve që duhet të monitorohen për ngjala dhe salmon përcaktohet në nivel rajonal. Përzgjedhja e rezervave nga të cilat duhet të grumbullohen këto variabla koordinohen në nivel rajonal bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë;

3. Të dhëna për të vlerësuar ndikimin e peshkimit nga BE-ja në ekosistemet detare në ujërat e BE-së dhe në ujërat jashtë tij.

Këto të dhëna përbëhen nga elementet e mëposhtme:

a) Për të gjitha llojet e peshkimit, kapjet shtesë aksidentale nga të gjithë shpendët, gjitarët dhe zvarranikët dhe peshqit e mbrojtur nga legjislacioni i BE-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke përfshirë speciet e paraqitura në tabelën 1D, duke përfshirë mungesën e kapjes së peshqve, gjatë ekspeditave vrojtuese shkencore në anije peshkimi ose nga vetë peshkatarët nëpërmjet regjistrave të peshkimit.

Kur të dhënat e grumbulluara gjatë ekspeditave të vrojtimit nuk konsiderohen se ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për kapjet shtesë aksidentale për nevojat e përdoruesve fundorë, shtetet anëtare zbatojnë metodologji të tjera. Përzgjedhja e këtyre metodologjive koordinohet në nivel rajoni detar dhe bazohet në nevojat e përdoruesve fundorë.

b) Të dhëna që ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit të peshkimit në ujërat e BE-së dhe në ujërat jashtë BE-së në habitatet detare.

Variablat e përdorura për të vlerësuar ndikimin e peshkimit në habitatin detar janë ato që regjistrohen në zbatim të Rregullores (KE) nr. 1224/2009. Të dhënat ndahen sipas nivelit 3 të veprimtarisë së peshkimit⁹, përveç se kur në nivel rajonal kërkohet një nivel më i ulët agregimi, në veçanti në rastet e zonave të mbrojtura detare.

Në rastet kur të dhënat e regjistruara sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009 nuk kanë rezolucion të saktë ose nuk kanë cilësi ose mbulim të mjaftueshëm për përdorimin e synuar shkencor, ato grumbullohen në një mënyrë tjetër alternative duke përdorur metoda të përshtatshme kampionimi. Të dhënat e regjistruara sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009 duhet të bëhen të disponueshme në nivelin e duhur të agregimit për institucionet kombëtare që zbatojnë planet e punës.

c) Të dhënat për vlerësimin e nivelit të peshkimit dhe ndikimit të veprimtarive të peshkimit në burimet biologjike detare dhe në ekosistemet detare, siç janë ndikimet në speciet jotregtare, marrëdhëniet grabitqar-pre dhe vdekshmëria natyrore e specieve të peshkut në secilin rajon detar.

Këto të dhëna fillimisht vlerësohen në studimet pilot. Bazuar në rezultatet e këtyre studimeve pilot, shtetet anëtare përcaktojnë grumbullimet e ardhshme të të dhënave për secilin rajon detar, të koordinuara në nivel rajoni detar dhe bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë.

4. Të dhëna të detajuara për veprimtarinë e anijeve të peshkimit¹⁰ në ujërat e BE-së dhe jashtë ujërave të BE-së, siç janë regjistruar sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009.

Të dhënat për vlerësimin e veprimtarisë së anijeve të peshkimit të BE-së në ujërat e BE-së dhe jashtë ujërave të BE-së përbëhen nga variablat e paraqitura në tabelën 4. Të dhënat e regjistruara, raportuara dhe transmetuara sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009 duhet të bëhen të disponueshme si të dhëna parësore për institucionet kombëtare që zbatojnë planet e punës. Në rastet kur këto të dhëna nuk duhet të grumbullohen sipas Rregullores (KE) nr. 1224/2009, ose kur të dhënat e grumbulluara sipas kësaj rregulloreje nuk kanë rezolucion të saktë ose nuk kanë cilësi ose mbulim të mjaftueshëm për përdorimin e synuar shkencor, ato grumbullohen në një mënyrë tjetër alternative duke përdorur metoda të përshtatshme kampionimi. Këto metoda lejojnë parashikimin e variablave të paraqitura në tabelën 4, në nivelin gjeografik përkatës më të ulët sipas segmentit të flotës (tabela 5a) dhe profesionit të përcaktuar në nivelin 6 (tabela 2).

5. Të dhëna sociale dhe ekonomike për peshkimin, të cilat mundësojnë vlerësimin e performancës sociale dhe ekonomike të sektorit të peshkimit në BE.

Këto të dhëna përbëhen nga elementet e mëposhtme:

a) Variablat ekonomike, siç tregohen në tabelën 5A sipas segmentimit të sektorit në tabelën 5B dhe sipas super-rajoneve, siç përcaktohet në tabelën 5C.

Popullata përbëhet nga të gjitha anijet e peshkimit aktive dhe aktive të regjistruara në Regjistrimin e Flotës së Peshkimit në Bashkimin Evropian, siç përcaktohet në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 26/2004¹¹ më 31 dhjetor të vitit të raportimit dhe anijet e peshkimit që nuk janë pjesë e regjistrimit në atë datë, por kanë peshkuar të paktën një ditë gjatë vitit të raportimit

Për anijet joaktive të peshkimit do të grumbullohen të dhëna vetëm për vlerën e kapitalit dhe koston e kapitalit.

Në rastet kur ekziston rreziku i identifikimit të personave fizikë dhe/ose subjekteve juridike, atëherë për raportimin e variablave ekonomike mund të zbatohet grupimi i të dhënave

për të garantuar konfidencialitetin statistikor. Grupimi gjithashtu mund të përdoret, nëse është e nevojshme, për të hartuar një plan kampionimi të saktë nga ana statistikore. Një skemë e tillë grupimi mbetet konsistente me kalimin e kohës.

Të dhënat ekonomike grumbullohen çdo vit.

b) Variablat sociale, siç paraqiten në tabelën 6.

Të dhënat sociale grumbullohen çdo tre vjet, duke nisur që nga viti 2018.

Të dhënat për punësimin sipas nivelit arsimor dhe punësimin sipas kombësisë do të grumbullohen gjatë studimeve pilot.

6. Të dhënat sociale, ekonomike dhe mjedisore për akuakulturën detare dhe opsionalisht për akuakulturën në ujërat e ëmbla, për të mundësuar vlerësimin e performancës sociale, ekonomike dhe mjedisore të sektorit të akuakulturës në BE.

Këto të dhëna përbëhen nga elementet e mëposhtme:

a) Variablat ekonomike, siç tregohen në tabelën 7, sipas segmentimit të sektorit, të paraqitur në tabelën 9.

Popullata përbëhet nga të gjitha sipërmarrjet veprimtaria parësore të së cilave përcaktohet sipas klasifikimit evropian të veprimtarive ekonomike NACE¹² kodet 03.21 dhe 03.22 dhe të cilat janë organizma fitimprurëse.

Të dhënat ekonomike grumbullohen çdo vit.

b) Variablat sociale, siç paraqiten në tabelën 6.

Të dhënat sociale grumbullohen çdo tre vjet, duke nisur që nga viti 2018.

Të dhënat për punësimin sipas nivelit arsimor dhe punësimin sipas kombësisë do të grumbullohen gjatë studimeve pilot.

c) Të dhënat mjedisore për akuakulturën, siç tregohen në tabelën 8, për të mundësuar vlerësimin e aspekteve të performancës së tij mjedisore.

Të dhënat mjedisore mund të grumbullohen gjatë studimeve pilot dhe të ekstrapolohen për të treguar vlerat totale që lidhen me volumin total të peshkut që prodhohet në shtetin anëtar.

Të dhënat mjedisore grumbullohen çdo dy vjet.

KREU IV

STUDIME SHKENCORE NË DET

1. Përveç rasteve kur një shqyrtim i studimeve çon në përfundimin se një studim nuk shërben më për të dhënë informacione për vlerësimin e rezervave dhe menaxhimin e peshkimit,

duhet të kryhen të paktën të gjitha studimet shkencore në det që paraqiten në tabelën 10. Bazuar në të njëjtat kritere të shqyrtimit shkencor, kësaj table mund t'i shtohen studime të reja.

2. Si pjesë e planeve të punës, të përcaktuara në nenin 21 të Rregullores (BE) nr. 508/2014, shtetet anëtare përcaktojnë studimet shkencore në det, që duhet të kryhen dhe mbajnë përgjegjësi për këto studime.

3. Kontributi përkatës i shteteve anëtare në studimet shkencore ndërkombëtare koordinohet brenda të njëjtit rajon detar.

4. Brenda planeve kombëtare të punës shtetet anëtare garantojnë vazhdimësinë me përgatitjet e studimeve të mëparshme.

KREU V

KUFIJTË E PESHKIMIT

1. Ky krye zbatohet për peshkimin në Bashkimin Evropian

2. Nuk është nevoja që të grumbullohen të dhëna biologjike, në rast se, për rezervën e një peshku ose specieje të caktuar:

a) niveli i lejuar i kapjes (TAC) në një shtet anëtar përfaqëson më pak se 10% se niveli total i BE-së; ose

b) në rast se nuk është caktuar një TAC, zbarkimet totale të një shteti anëtar për një rezervë ose specie përfaqësojnë më pak se 10% të zbarkimeve totale mesatare të BE-së gjatë 3 viteve të fundit; ose

c) zbarkimet totale vjetore të një shteti anëtar për një specie janë më të ulëta se 200 ton. Për speciet për të cilat nevojitet një menaxhim specifik, mund të vendoset një cak më i ulët në nivel rajoni detar.

Kur shuma e kuotave përkatëse të disa shteteve anëtare, TAC e të cilëve është më e ulët se 10%, është më e lartë se 25% e përqindja e TAC për një rezervë të caktuar, caku prej 10% që përmendet në germën "a" nuk gjen zbatim dhe shtetet anëtare garantojnë ndarjen e detyrave në nivel rajonal për të garantuar që rezerva të mbulohet nga kampionimi në përputhje me nevojat e përdoruesve fundorë.

Për speciet e mëdha pelagjike dhe speciet anadrome dhe katadrome nuk vendoset asnjë cak peshkimi.

3. Pa cenuar dispozitat më specifike që lidhen me detyrimet ndërkombëtare sipas organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit (RFMO), nuk është nevoja që të mblidhen të dhëna biologjike, nëse, për një rezervë peshku të shfrytëzuar në nivel ndërkombëtar, përveç rezervave të specieve të mëdha pelagjike ose specieve me nivel të lartë migrimi, përqindja e BE-së është më e vogël se 10%.

4. Shtetet anëtare bëjnë parashikime për kapjet nga studimet ekzistuese për peshkimin çlodhës/zbavitës, duke përfshirë ato që kryhen në kuadër të grumbullimit të të dhënave ose nga një studim pilot shtesë, dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Këto studime lejojnë llogaritjen e përqindjes së kapjeve gjatë peshkimit çlodhës/zbavitës në lidhje me kapjet nga peshkimi tregtar për të gjitha speciet në një rajon detar për të cilin kërkohen parashikime të kapjeve nga peshkimi çlodhës/zbavitës në zbatim të këtij plani shumëvjeçar të BE-së. Hartimi dhe shtrirja e mëpasshme e studimeve kombëtare për peshkimin çlodhës/zbavitës, duke përfshirë çdo cak për mbledhjen e të dhënave, koordinohet në nivel rajoni detar dhe bazohet në nevojat e përdoruesve fundorë.

Për peshkimin çlodhës/argëtues në rezervat e peshkut që janë subjekt i planeve shumëvjeçare të menaxhimit ose rikuperimit, si ato që zbatohen për speciet e mëdha pelagjike ose speciet shumë migratore, nuk vendosen caqe.

5. Nuk është e nevojshme që të grumbullohen të dhëna sociale dhe ekonomike, nëse prodhimi total i shtetit anëtar është më i ulët se 1% e volumit dhe vlerës totale të prodhimit në BE. Nuk është e nevojshme që të grumbullohen të dhëna për akuakulturën për speciet që përfaqësojnë më pak se 10% të prodhimit të akuakulturës në shtetin anëtar, sipas volumit dhe vlerës. Gjithashtu, shtetet anëtare që kanë një prodhim total më të ulët e 2,5% të volumit dhe vlerës totale të prodhimit të akuakulturës në BE përcaktojnë një metodologji të thjeshtësuar, siç janë studimet pilot, me qëllim për të ekstrapoluar të dhënat që kërkohen për speciet që përfaqësojnë më shumë se 10% të prodhimit të akuakulturës në BE, sipas volumit dhe vlerës.

Të dhënat referencë janë dorëzimet më të fundit që shtetet anëtare kanë bërë sipas Rregullores (KE) nr. 762/2008 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹³ dhe të dhënat përkatëse të publikuara nga Eurostat.

6. Nuk është e nevojshme që të grumbullohen të dhëna mjedisore, nëse prodhimi total i akuakulturës në shtetin anëtar është më i ulët se 2,5 % e volumit dhe vlerës totale të prodhimit të akuakulturës në BE.

Të dhënat referencë janë dorëzimet më të fundit që shtetet anëtare kanë bërë sipas Rregullores (KE) nr. 762/2008 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe të dhënat përkatëse të publikuara nga Eurostat.

7. Pjesëmarrja e një shteti anëtar (fizike ose financiare) në studimet shkencore në det të paraqitura në tabelën 10 nuk është e detyrueshme kur përqindja e saj në një TAC të BE-së për një specie që është objekt i studimit është nën cakun prej 3%. Kur nuk është përcaktuar asnjë TAC, pjesëmarrja e një shteti anëtar (fizike ose financiare) në studimet shkencore në det nuk është e detyrueshme kur përqindja e saj në zbatimet totale të BE-së gjatë 3 viteve të fundit për një rezervë ose specie është nën cakun prej 3%. Caqet për studimet për speciet e shumfishta dhe ekosistemin mund të përcaktohen në nivel rajoni detar.

8. Pavarësisht pikave 2 deri në 7, brenda të njëjtit rajon detar, shtetet anëtare mund të miratojnë caqe alternative.

TË DHËNA BIOLOGJIKE

TABELA 1A

REZERVAT NË UJËRAT E BE-SË

Specia (emri i zakonshëm)	Specia (emri shkencor)	Zona (ICES ¹⁴ , IBSFC ¹⁵ ose kodet e zonës nga FAO ¹⁶) ku ndodhet rezerva/kodi i rezervës
Arktiku Lindor, Deti i Norvegjisë dhe Deti Barents		
Ngjala	Anguilla anguilla	I, II
Peshk i gjatë lumi	Brosme brosme	I, II
Harena atlantiko-skandinave	Clupea harengus	I, II,
Merluci	Gadus morhua	I, II
Sardele	Mallotus villosus	I, II
Merluc	Melanogrammus aeglefinus	I, II
Merluc trependësh	Micromesistius poutassou	I-II
Karkaleci i kuq	Pandalus borealis	I, II
Merluc i Atlantikut Verior	Pollachius virens	I, II
Shojzë e Groenlandës	Reinhardtius hippoglossoides	I, II
Salmon	Salmo salar	I, II
Skumri	Scomber scombrus	II,
Peshku i kuq	Sebastes marinus.	I, II
Peshku i kuq me sqep	Sebastes mentella.	I, II
Stavridhët	Trachurus trachurus	IIa,
Skagerrak dhe Kattegat		
Ngjala e rërës	Ammodytidae	IIIa

Ngjala	Anguilla anguilla	IIIa
Harenga	Clupea harengus	IIIa/22-24, IIIa
Grenadieri hundërrumbullakët	Coryphaenoides rupestris	IIIa
Gjel gri	Eutrigla gurnardus	IIIa
Gjel i kuq	Aspitrigla cuculus	IIIa,
Merluci	Gadus morhua	IIIaN
Merluci	Gadus morhua	IIIaS
Shojza sydjathtë	Glyptocephalus cynoglossus	IIIa
Shojzë e zakonshme	Limanda limanda	IIIa
Merluc	Melanogrammus aeglefinus	IIIa
Merluc i bardhë	Merlangius merlangus	IIIa
Merluc	Merluccius merluccius	IIIa,
Merluc trependësh	Micromesistius poutassou	IIIa
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	Njësia funksionale
Karkaleci i kuq	Pandalus borealis	IIIa
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	IIIa
Merluc i Atlantikut Verior	Pollachius virens	IIIa
Salmon	Salmo salar	IIIa
Shkoter	Psetta maxima	IIIa

Skumri	Scomber scombrus	IIIa
Bishtmëllenjëza	Scophthalmus rhombus	IIIa
Gjuhëz	Solea solea	IIIa
Papaline	Sprattus sprattus	IIIa
Norway pout	Trisopterus esmarki	IIIa
Të gjithë peshkaqenët dhe rajet që përdoren për qëllime tregtare ¹⁷	Selachii, Rajidae	IIIa
Deti Balltik -		
Ngjala	Anguilla anguilla	22-32
Harenga	Clupea harengus	22-24/25-29, 32/30/31/Gjiri i Rigës
Salmon i zakonshëm	Coregonus lavaretus	IIIId
Vendace	Coregonus albula	22-32
Merluci	Gadus morhua	22-24/25-32
Shojzë e zakonshme	Limanda limanda	22-32
Shkerp	Perca fluviatilis	IIIId
Shojzë	Platichthys flesus	22-32
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	22-32
Shkoter	Psetta maxima	22-32
Salmon	Salmo salar	22-31/32
Troftë deti	Salmo trutta	22-32
Luci	Sander lucioperca	IIIId
Bishtmëllenjëza	Scophthalmus rhombus	22-32

Gjuhëz	<i>Solea solea</i>	22
Papaline	<i>Sprattus sprattus</i>	22-32
Deti i Veriut dhe Kanali Lindor		
Ngjala e rërës	Ammodytidae	IV
Peshk mace	<i>Anarhichas spp.</i>	IV
Ngjala	<i>Anguilla anguilla</i>	IV, VIIId
Troftë deti	<i>Argentina spp.</i>	IV
Gjel gri	<i>Eutrigla gurnardus</i>	IV
Peshk i gjatë lumi	<i>Brosme brosme</i>	IV
Harenga	<i>Clupea harengus</i>	IV, VIIId
Karkalec i zakonshëm	<i>Crangon crangon</i>	IV, VIIId
Levrek deti	<i>Dicentrarchus labrax</i>	IV, VIIId
Gjel gri	<i>Eutrigla gurnardus</i>	IV
Merluci	<i>Gadus morhua</i>	IV, VIIId
Shojza sydjathtë	<i>Glyptocephalus cynoglossus</i>	IV
Shkerpi gojëblu	<i>Helicolenus dactylopterus</i>	IV
Peshk tullë	<i>Lepidorhombus boscii</i>	IV, VIIId
Shojzë deti	<i>Lepidorhombus whiffiagonis</i>	IV, VIIId
Shojzë e zakonshme	<i>Limanda limanda</i>	IV, VIIId
Hënëz deti	<i>Lophius budegassa</i>	IV, VIIId
Peskatrice	<i>Lophius piscatorius</i>	IV

Granadier kokëmadh	Macrourus berglax	IV
Merluc	Melanogrammus aeglefinus	IV
Merluc i bardhë	Merlangius merlangus	IV, VIIId
Merluc	Merluccius merluccius	IV VII
Merluc trependësh	Micromesistius poutassou	IV, VIIId
Gjuhëza e verdhë	Microstomus kitt	IV, VIIId
Blue ling	Molva dypterygia	IV
Motele	Molva molva	IV
Barbun i shkëmbit	Mullus barbatus	IV, VIIId
Barbun i shkëmbit me vija	Mullus surmuletus	IV, VIIId
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	Të gjitha njësitet funksionale
Karkaleci i kuq	Pandalus borealis	IVa lindje/IVa/IV
Gocë deti	Pecten maximus	VIIId
Peshk-fik i bardh;	Phycis blennoides	IV
Peshk-fik i zi	Phycis phycis	IV
Shojzë	Platichthys flesus	IV
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	IV
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	VIIId
Merluc i Atlantikut Verior	Pollachius virens	IV
Shkoter	Psetta maxima	IV, VIIId

Shojzë e Groenlandës	Reinhardtius hippoglossoides	IV
Salmon	Salmo salar	IV, VIId
Skumri	Scomber scombrus	IV, VIId
Bishtmëllenjëza	Scophthalmus rhombus	IV, VIId
Peshk i kuq	Sebastes mentella.	IV
Gjuhëz	Solea solea	IV
Gjuhëz	Solea solea	VIId
Papaline	Sprattus sprattus	IV/VIId
Stavridhët	Trachurus trachurus	IV, VIId
Gjel i hirtë	Trigla lucerna	IV
Norway pout	Trisopterus esmarki	IV
Peshk kovaç	Zeus faber	IV, VIId
Të gjithë peshkaqenët dhe rajet që përdoren për qëllime tregtare ¹⁷	Selachii, Rajidae	IV, VIId
Atlantiku verilindor dhe kanali perëndimor		
Smoothhead	Alepocephalus bairdii	VI, XII
Ngjala e rërës	Ammodytidae	VIa
Peshk bilbil	Capros aper	V, VI, VII
Scallop	Pecten maximus	IV, VI, VII
Queen scallop	Aequipecten opercularis	VII
Spider crab	Maja squinado	V, VI, VII

Ngjala	<i>Anguilla anguilla</i>	Të gjitha zonat
Peshk jatagan	<i>Aphanopus spp.</i>	Të gjitha zonat
Troftë deti	<i>Argentina spp.</i>	Të gjitha zonat
Ame	<i>Argyrosomus regius</i>	Të gjitha zonat
Gjel i kuq	<i>Aspitrigla cuculus</i>	Të gjitha zonat
Alfonsinos	<i>Beryx spp.</i>	Të gjitha zonat, me përjashtim të X dhe IXa
Alfonsinos	<i>Beryx spp.</i>	IXa dhe X
Gaforre e ngrëshme	<i>Cancer pagurus</i>	Të gjitha zonat
Harena	<i>Clupea harengus</i>	VIa/VIaN/ VIa S, VIIbc/VIIa/VIIj
Ngjalë e egër	<i>Conger conger</i>	Të gjitha zonat, me përjashtim të X
Ngjalë e egër	<i>Conger conger</i>	X
Grenadieri hundërrumbullakët	<i>Coryphaenoides rupestris</i>	Të gjitha zonat
Peshkaqen	<i>Dalatias licha</i>	Të gjitha zonat
Shkotërr	<i>Dasyatis pastinaca</i>	VII, VIII
Peshkaqen hundësqep	<i>Deania calcea</i>	V, VI, VII, IX, X, XII
Levrek deti	<i>Dicentrarchus labrax</i>	Të gjitha zonat, me përjashtim të IX
Levrek deti	<i>Dicentrarchus labrax</i>	IX
Wedge sole	<i>Dicologlossa cuneata</i>	VIIIc, IX
Açuga	<i>Engraulis encrasicolus</i>	IXa (vetëm Cádiz)
Açuga	<i>Engraulis</i>	VIII

	encrasicolus	
Peshkaqen	Etmopterus spinax	VI, VII, VIII
Gjel gri	Eutrigla gurnardus	VIIId,e
Merluci	Gadus morhua	Va/Vb/VIa/VIb/VIIa/VIIe-k
Witch	Glyptocephalus cynoglossus	VI, VII
Bluemouth rockfish	Helicolenus dactylopterus	Të gjitha zonat
Karavidhe	Homarus gammarus	Të gjitha zonat
Orange roughy	Hoplostethus atlanticus	Të gjitha zonat
Peshk jatagan	Lepidopus caudatus	IXa
Peshk tullë	Lepidorhombus boscii	VIIIc, IXa
Shojzë deti	Lepidorhombus whiffiagonis	VI/VII, VIIIabd/VIIIc, IXa
Shojzë e zakonshme	Limanda limanda	VIIe/VIIa,f-h
Kallamar i zakonshëm	Loligo vulgaris	të gjitha zonat, me përjashtim të VIIIc, IXa
Kallamar i zakonshëm	Loligo vulgaris	VIIIc, IXa
Hënëz deti	Lophius budegassa	IV, VI/VIIb-k, VIIIabd
Hënëz deti	Lophius budegassa	VIIIc, IXa
Peskatrice	Lophius piscatorius	IV, VI/VIIb-k, VIIIabd
Peskatrice	Lophius piscatorius	VIIIc, IXa
Sardele	Mallotus villosus	XIV
Merluc	Melanogrammus	Va/Vb

	aeglefinus	
Merluc	Melanogrammus aeglefinus	VIa/VIb/VIIa/VIIb-k
Merluc i bardhë	Merlangius merlangus	VIII/IX, X
Merluc i bardhë	Merlangius merlangus	Vb/VIa/VIb/VIIa/VIIe-k
Merluc	Merluccius merluccius	IIIa, IV, VI, VII, VIIIab/VIIIc, IXa
Wedge sole	Microchirus variegatus	Të gjitha zonat
Merluc trependësh	Micromesistius poutassou	I-IX, XII, XIV
Gjuhëza e verdhë	Microstomus kitt	Të gjitha zonat
Motele pendëblu	Molva dypterygia	Të gjitha zonat, me përjashtim të X
Spanish ling	Molva macrophthalma	X
Motele	Molva molva	Të gjitha zonat
Barbun i shkëmbit me vija	Mullus surmuletus	Të gjitha zonat
Palomb	Mustelus asterias	VI, VII, VIII, IX
Palomb	Mustelus mustelus	VI, VII, VIII, IX
Blackspotted smooth-hound	Mustelus punctulatus	VI, VII, VIII, IX
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	Njësia funksionale VI
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	Njësia funksionale VII
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	Njësia funksionale VIII, IX

Oktapod i zakonshëm	Octopus vulgaris	të gjitha zonat, me përjashtim të VIIIc, IXa
Oktapod i zakonshëm	Octopus vulgaris	VIIIc, IXa
Spalcë e kuqe	Pagellus bogaraveo	IXa, X
Pandalid shrimps	Pandalus spp.	Të gjitha zonat
Karkaleci rozë	Parapenaeus longirostris	IXa
Peshk-fik i bardh;	Phycis blennoides	Të gjitha zonat
Peshk-fik i zi	Phycis phycis	Të gjitha zonat
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	VIIa/VIIe/VIIIfg
Gjuhëz evropiane	Pleuronectes platessa	VIIbc/VIIh-k/VIII, IX, X
Pollack	Pollachius pollachius	të gjitha zonat përveç IX, X
Pollack	Pollachius pollachius	IX, X
Merluc i Atlantikut Verior	Pollachius virens	Va/Vb/IV, IIIa, VI
Merluc i Atlantikut Verior	Pollachius virens	VII, VIII
Kerr fundi	Polyprion americanus	X
Shkoter	Psetta maxima	Të gjitha zonat
Shojzë e Groenlandës	Reinhardtius hippoglossoides	V, XIV/VI
Shojzë e halibutit	Hippoglossus hippoglossus	V, XIV
Salmon	Salmo salar	Të gjitha zonat
Sardele	Sardina pilchardus	VIIIabd/VIIIc, IXa

Skumri spanjoll	<i>Scomber colias</i>	VIII, IX, X
Skumri	<i>Scomber scombrus</i>	II, IIIa, IV, V, VI, VII, VIII, IX
Bishtmëllenjëza	<i>Scophthalmus rhombus</i>	Të gjitha zonat
Peshku i kuq	<i>Sebastes marinus</i>	Nënzonat ICES V, VI, XII, XIV dhe NAFO SA 2 + (Div. 1F + 3K).
Peshku i kuq me sqep	<i>Sebastes mentella</i>	Nënzonat ICES V, VI, XII, XIV dhe NAFO SA 2 + (Div. 1F + 3K)
Sepie	<i>Sepia officinalis</i>	Të gjitha zonat
Gjuhëz	<i>Solea solea</i>	VIIa/VIIfg
Gjuhëz	<i>Solea solea</i>	VIIbc/VIIhjk/IXa/VIIIc
Gjuhëz	<i>Solea solea</i>	VIIe
Gjuhëz	<i>Solea solea</i>	VIIIab
Mormur (shumës)	Sparidae	Të gjitha zonat
Stavridh mesdhetar	<i>Trachurus mediterraneus</i>	VIII, IX
Stavridh kanali	<i>Trachurus picturatus</i>	VIII, IX, X
Stavridhët	<i>Trachurus trachurus</i>	IIa, IVa, Vb, VIa, VIIa-c, e-k, VIIIabde/X
Stavridhët	<i>Trachurus trachurus</i>	VIIIc, IXa
Pouting	<i>Trisopterus spp.</i>	Të gjitha zonat
Peshk kovaç	<i>Zeus faber</i>	Të gjitha zonat
Të gjithë peshkaqenët dhe rajet që përdoren për qëllime tregtare ¹⁷	Selachii, Rajidae	IV, VIId
Deti Mesdhe dhe Deti i Zi		
Ngjala	<i>Anguilla anguilla</i>	të gjitha zonat në Mesdhe

Giant red shrimp	Aristeomorpha foliacea	të gjitha zonat në Mesdhe
karkaleci i kuq	Aristeus antennatus	të gjitha zonat në Mesdhe
Vopa	Boops boops	1,3, 2,1, 2,2, 3,1, 3,2
Korifena	Coryphaena equiselis	të gjitha zonat në Mesdhe
Korifena	Coryphaena hippurus	të gjitha zonat në Mesdhe
Levrek deti	Dicentrarchus labrax	të gjitha zonat në Mesdhe
Horned/curled octopus	Eledone cirrhosa	1,1, 1,3, 2,1, 2,2, 3,1
Musky octopus	Eledone moschata	1,3, 2,1, 2,2, 3,1
Açuga	Engraulis encrasicolus	të gjitha zonat në Mesdhe
Açuga	Engraulis encrasicolus	Nënzona (GSA) e Detit të Zi 29
Gjel gri	Eutrigla gurnardus	2.2, 3.1
Kallamar	Illex spp., Todarodes spp.	të gjitha zonat në Mesdhe
Billfish	Istiophoridae	të gjitha zonat në Mesdhe
Kallamar i zakonshëm	Loligo vulgaris	të gjitha zonat në Mesdhe
Hënëz deti	Lophius budegassa	1,1, 1,2, 1,3, 2,2, 3,1
Peskatrice	Lophius piscatorius	1,1, 1,2, 1,3, 2,2, 3,1
Merluc i bardhë	Merlangius merlangus	GSA e Detit të Zi 29
Merluc	Merluccius merluccius	të gjitha zonat në Mesdhe
Merluc trependësh	Micromesistius	1.1, 3.1

	poutassou	
Qefujt	Mugilidae	1,3, 2,1, 2,2, 3,1
Barbun i shkëmbit	Mullus barbatus	të gjitha zonat në Mesdhe
Barbun i shkëmbit	Mullus barbatus	GSA e Detit të Zi 29
Barbun i shkëmbit me vija	Mullus surmuletus	të gjitha zonat në Mesdhe
Oktapod i zakonshëm	Octopus vulgaris	të gjitha zonat në Mesdhe
Karavidhe norvegjeze	Nephrops norvegicus	të gjitha zonat në Mesdhe
Spalcë e kuqe	Pagellus erythrinus	të gjitha zonat në Mesdhe
Karkalec rozë	Parapenaeus longirostris	të gjitha zonat në Mesdhe
Caramote prawn	Penaeus kerathurus	3.1
Shkoter	Psetta maxima	GSA e Detit të Zi 29
Sardele	Sardina pilchardus	të gjitha zonat në Mesdhe
Skumri	Scomber spp.	të gjitha zonat në Mesdhe
Sepie	Sepia officinalis	të gjitha zonat në Mesdhe
Gjuhëz	Solea vulgaris	1,2, 2,1, 3,1
Koce	Sparus aurata	1.2, 3.1
Kantari	Spicara smaris	2,1, 3,1, 3,2
Papaline	Sprattus sprattus	GSA e Detit të Zi 29
Cikale	Squilla mantis	1,3, 2,1, 2,2
Stavridh mesdhetar	Trachurus mediterraneus	të gjitha zonat në Mesdhe
Stavridh mesdhetar	Trachurus mediterraneus	GSA e Detit të Zi 29

Stavridhët	Trachurus trachurus	të gjitha zonat në Mesdhe
Stavridhët	Trachurus trachurus	GSA e Detit të Zi 29
Gjel i hirtë	Trigla lucerna	1,3, 2,2, 3,1
Clam	Veneridae	2.1, 2.2
Peshk kandil	Aphia minuta	GSA 9,10,16 dhe 19
Aterina	Atherina spp.	GSA 9,10,16 dhe 19
Peshk lakuriq	Trisopterus minutus	Të gjitha rajonet
Të gjithë peshkaqenët dhe rajet që përdoren për qëllime tregtare ¹⁷	Selachii, Rajidae	Të gjitha rajonet

TË DHËNA BIOLOGJIKE

TABEL 1B

REZERVAT E RAJONEVE MË TË LARGËTA TË BE-SË

Specia (emri i zakonshëm)	Specia (emri shkencor)
Guajana Franceze	
Red snapper	Lutjanus purpureus
Prawns	Farfantepenaeus subtilis
Acoupa weakfish	Cynoscion acoupa
Smalltooth weakfish	Cynoscion steindachneri
Green weakfish	Cynoscion virescens
Sea catfishes	Ariidae
Tripletail	Lobotes surinamensis
Torroto grunt	Genyatremus luteus
Snooks	Centropomus spp.

Açuga	Serranidae
Barbun	Mugil spp.
Guadalupe dhe Martinikë	
Snappers	Lutjanidae
Grunters	Haemulidae
Açuga	Serranidae
Lule peshk	Pterois volitans
Tuna-like fish	Scombridae
Marlin blu	Makaira nigricans
Korifena	Coryphaena hippurus
Reunion dhe Majote	
Snappers	Lutjanidae
Açuga	Serranidae
Tuna-like fish	Scombridae
Peshku shpatë	Xiphias gladius
Other bill fishes	Istiophoridae
Korifena	Coryphaena hippurus
Bigeye scad	Selar crumenophthalmus
Azore, Madeira dhe Ishujt Kanare	
Atlantic chub mackerel	Scomber colias
Sardinele	Sardinella maderensis
Stavridhët	Trachurus spp.
Sardele	Sardina pilchardus

Parrotfish	Sparisoma cretense
Limpets	Patellidae

TË DHËNA BIOLOGJIKE

TABELA 1C

REZERVAT NË ZONAT DETARE QË MONITOROHEN NGA ORGANIZATAT RAJONALE PËR MENAXHIMIN E PESHKIMIT (RFMO) DHE MARRËVESHJET E PARTNERITETIT PËR PESHKIM TË QËNDRUESHËM (SFPA)

IATTC (Komisioni Ndëramerikan për Peshkun Ton Tropikal)

SPECIET				Shpeshhtësia e grumbullimit të variablave biologjike
Për hartimin e planeve të kampionimit që kanë si qëllim të grumbullojnë informacione biologjike, siç përcaktohen në kreun III të kësaj shtojce, merren në konsideratë kufijtë e rezervës së peshkut, siç përcaktohen nga RFMO-të kompetente ose organizatat rajonale të peshkimit (RFO) dhe për çdo rezervë alokohen burimet e përshtatshme për kampionim.				
Emri shkencor	Emri i zakonshëm	Zona gjeografike	Prioritet	Mbledhja e të dhënave bëhet çdo vit dhe përditësimi/përpunimi i të dhënave duhet të kryhet në kohë, sipas programit të vlerësimeve të rezervës.
Thunnus albacares	Toni pendëverdhe	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Thunnus obesus	Toni symadh	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Katsuwonus pelamis	Palamida	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Thunnus alalunga	Toni pendëgjatë	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Thunnus orientalis	Toni blu i paqësorit	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Xiphias gladius	Peshku shpatë	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Makaira nigricans	Marlin blu	Oqeani Paqësor	E lartë	

(or mazara)		Lindor		
Makaira indica	Marlin i zi	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	
Tetrapturus audax	Marlin me vija	Oqeani Paqësor Lindor	E lartë	

ICCAT (Komisioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut)

SPECIET				Shpeshhtësia e grumbullimit të variablave biologjike
<p>Për hartimin e planeve të kampionimit që kanë si qëllim të grumbullojnë informacione biologjike, siç përcaktohen në kreun III të kësaj shtojce, merren në konsideratë kufijtë e rezervës së peshkut, siç përcaktohen nga RFMO-të ose RFO-të kompetente dhe për çdo rezervë alokohen burimet e përshtatshme për kampionim.</p>				
Emri shkencor	Emri i zakonshëm	Zona gjeografike	Prioritet	Mbledhja e të dhënave bëhet çdo vit dhe përditësimi/përpunimi i të dhënave duhet të kryhet në kohë, sipas programit të vlerësimeve të rezervës.
Thunnus albacares	Toni pendëverdhë	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Thunnus obesus	Toni symadh	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Katsuwonus pelamis	Palamida	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Thunnus alalunga	Toni pendëgjatë	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Thunnus thynnus	Toni i kuq	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Xiphias gladius	Peshku shpatë	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Makaira nigricans (or mazara)	Marlin blu	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	
Istiophorus albicans	Peshku velë	Oqeani Atlantik dhe detet afër tij	E lartë	

